REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njesia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 01
Nr.Prot
Broj Prot
Prot.No. 05-5613
Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -2-
Data:
Datum:
Date: 11/08/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit– Ured Ministra –Office of the Minister

Nr: 128/VIII/2026
Datë: 10/08 /2026

Zëvendësministri i Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 dhe 16 të Ligjit

Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shkresën nr.prot. 05 – 5547, datë 07.08.2026, si dhe nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale të Bartësve të autorizim marketingut dhe/ose përfaqësuesve të tyre **- Versioni 1.2.**

II. Afati i vlefshmërisë së çmimeve të produkteve medicinale është i përcaktuar në Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale e cila është pjesë e këtij vendimi.

III. Obligohen qarkulluesit me shumicë dhe pakicë që t'i përmbahen çmimeve të produkteve medicinale të përcaktuara në Listen e cila është pjesë e këtij Vendimi.

IV. Lista Zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale është pjesë e këtij Vendimi dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Agjencisë së Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m i

Bazuar në shkresën 05 – 5547, datë 07.08.2026, të Komisionit për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, me të cilën është kërkuar miratimi i Listës Zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, pasi janë përfunduar procedurat e ankesave nga Komisioni i Ankesave për Çmimin e Produkteve Medicinale ndaj listës preliminare të çmimeve të produkteve medicinale, të publikuara më datë 16.06.2026, (deklarimi qershor 2026) si dhe njoftimit për deklaratat nën betim nga bartësit e autorizim marketingut dhe përfaqësuesit e tyre se pajtohen me çmimet e publikuara në listën preliminare të datës 24.07.2026 dhe se nuk do të paraqesin ankesë, bazuar

në dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr.Arsim Berisha

Zëvendësminister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- *Zëvendësministrave të MSH-së;*
- *Sekretarit i Përgjithshëm;*
- *UD. Kryeshefit të AKPPM-së;,*
- *Z.Edon Muçaj, Kryesues i Komisionit;*
- *Komisionit të ankesave;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*